

P. nr.19/09

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, gjykata e shkallës së parë penale, me trupin gjykues në përbërje nga gjyqtarët Suzana Çerkini kryetare, Shadije Gerguri dhe Beqir Kalludra anëtarë, me sekretaren juridike Albulena Ademi në çështjen penale kundër të akuzuarit B.N.nga F.K., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut tani Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, PP.nr.843-2/08 të datës 16.01.2009, pas shqyrtimit gjyqësor të hapur për publikun, të mbajtur më datë 14.08.2018, me praninë e Prokurorit të shtetit Hivzi Bajraktari dhe të akuzuarit B.N.1, të njëjtën ditë mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari B.N.1, i biri i Sh. dhe nënës S. e vajzërisë H. i lindur me ... në P. me venbanim në F.K. Rr”A.Z.” Nr...., momentalisht jeton dhe punon në Gj., i martuar, baba i ... fëmijëve, ka te kryer shkollën e mesme, i gjendjes se mesme ekonomike, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikaur me LNJ të RKS me numër personal ...,

ËSHTË FAJTOR

Sepse, me datën 22.10.2008 rreth orës 19:30 në shtëpinë e tij në Rr”A.Z.” Nr... në F.K., pas një mosmarrëveshjeje me prindin e tij Sh.N., e ka përdorë armën me kërcënim, në atë mënyrë që seriozisht i’u ka kanosur të dëmtuarit- babait të tij Sh.N. duke ia drejtuar pistoletën e tipit Zastava e kal 6.35 mm, me nr serik T690570 në të cilën kanë qenë dy fishekë dhe duke i thënë të njëjtit se nëse edhe njëherë ndodh e njëjta gjë, ndryshe do të ndahemi,

- me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK,

Andaj, gjykata, në bazë të neneve 11,15,34,39,54,60, 64 të KPK dhe neneve 326, 365 dhe 366 të KPP i shqipton,

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 750 (shtatëqindpesëdhjetë) euro, në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 23.10.2008 deri më 23.11.2008 ashtu që një ditë arresti i llogaritet me 15 (pesëmbëdhjetë) euro gjobë, ndërsa dënimi me gjobë i mbetur për t'u paguar është në shumë prej **300 (treqind) euro**,

Dënimin me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro, obligohet i akuzuari t'a paguajë në afatin jo më gjatë se tre muaj pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë, e nëse nuk e paguan gjobën e shqiptuar, gjykata do t'ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgimi llogaritet me 15 (pesëmbëdhjetë) euro gjobë.

DËNIM PLOTËSUES

Konfiskohet: psitoleta e tipit Zastava e kal 6.35 mm, me nr serik T690570 e precizuar si në procesverbalin e dëshmisë/pronës i bashkangjitur në shkresat e lëndës, 2008AE00995 të datës 23.10.2008,

I akuzuari obligohet t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor do të paguajë shumën prej 30 (tridhjetë) euro, në afat prej 15 ditësh pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë,

Kërkesë pasurore juridike nuk pati,

A r s y e t i m

Prokuroria Publike e Qarkut, tani Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, PP.nr.843-2/08 të datës 16.01.2009, ka akuzuar B.N.1 për vepër penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPRK si dhe B.N.2 për veprë penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPRK dhe, njëherësh i ka propozuar gjykatës që pas adminsitrimin të provave në shqyrtim gjyqësor, të akuzuarit t'i shpall fajtor dhe t'i dënojë sipas ligjit.

Gjykata, duke vepruar në këtë çështje penale sipas aktakuzës së lartshënuar, ndonëse të konfirmuar, fillimisht ka nxjerrë aktvendim të veçantë të datës 30.04.2018 me të cilin ka hudhë pjesërisht aktakuzën ndaj të akuzuarit B.N.2 dhe ndaj të njëjtit ka pushuar procedurën penale, për shkak se vepra penale me të cilën është akuzuar Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPRK është përfshirë në Ligjin për Amnistinë 2013/04-209 në fuqi nga data 04.10.2013, ndërsa, ka proceduar vetëm ndaj të akuzuarit B.N.1, ashtu që në shqyrtim gjyqësor të mbajtur me datë 14.08.2018 i akuzuari B.N.1, duke qenë në dijeni të plotë për natyrën, përparësitë dhe pasojat e pranimin të fajësisë, vullnetarisht pranoi në tërësi fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë me aktakuzë.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi që ky pranim i fajësisë është bërë konform neni 248 të KPP, njëherit pranimi i fajësisë është në pajtim me aktakuzën e cila është bazuar në shkrësat e lëndës andaj i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë.

Pas pranimin të fajësisë dhe pas mendimit të prokurorit të shtetit, gjykata duke vlerësuar se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është dhënë në përputhje me dispozitat ligjore nga neni 248 par.1 të KPP, se i njëjti në mënyrë bindëse dhe të vullnetshme ka pranuar fajësinë, duke qenë në dijeni për natyrën, pasojat e pranimin të fajësisë dhe në përputhje të plotë me faktet e provat nga shkrësat e lëndës dhe se, aktakuza nuk përmban shkelje të qartë ligjore e as gabime faktike, e aprovoi pranimin e fajësisë nga i akuzuari për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare theksoi se meqenëse i akuzuari e pranoi fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë si në aktakuzë, i ka propozuar gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, njëherit gjatë matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit ta merr si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë meqë i njëjti shprehu pendimin e thellë për rastin që ka ndodh.

I dëmtuari Sh.N. theksoi se nuk dëshiron të parashtojë kërkesë pasurore juridike dhe se është i pajtimin që të akuzuarit B.N.1 t'i shqiptohet një dënim sa më i butë meqë prej atëherë djali i tij B.1 është përmirësuar shumë dhe nuk ka gabuar asnjëherë tjetër. Andaj, gjykata fare nuk e udhëzoi të dëmtuarin në realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

I akuzuari B.N.1 në fjalën përfundimtare theksoi se ky ka qenë një momnet i keq për të, dhe herë e parë të ketë rënë ndesh me ligjin, asnjëherë nuk ka përsëritur veprim të tillë apo të ngjashëm, ndihet shumë i penduar dhe kërkon nga gjykata një dënim sa më të butë.

Gjykata, pas aprovimit të pranimin të fajësisë së të akuzuarit, pas vlerësimit të pretendimeve të palëve nga fjala e tyre përfundimtare si dhe pas vlerësimit të rrethanave të rastit, konstatoi gjendjen e fakteve që e përmban akuza, nxjerri konkluzion të drejtë dhe të ligjshëm, se në veprimet e të akuzuarit, ekzistojnë elementet e veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, andaj pasi që më parë gjeti se i akuzuari është penalisht përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor për veprën penale që i vihet në barrë dhe, i shqiptoi dënim të paraparë ligjor.

Me rastin e përcaktimit të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara ligjore që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si, rrethanat lehtësuese: pranimin e fajësisë si rrethanë posaçërisht lehtësuese, pendimin e shprehur, rrethanat familjare me të dëmtuarin të cilin e ka baba, premtimin e dhënë se nuk do t'a përsërisë veprën penale, ndërsa rrethanë rënduese nuk gjeti andaj, të njëjtit i shqiptoi dënim me gjobë, me bindje se dënimi i tillë i përgjigjet peshës së veprës penale, sjelljeve dhe shkallës së përgjegjësisë penale të t'akuzuarit, se ky dënim do të ndikojë në resocializimin e të njëjtit, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, gjithashtu, do të ndikojë tek të tjerët në mos kryerjen e veprave penale dhe se, me dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 34 të KPK dhe në fund dhe, me bindje se i akuzauri në të ardhmen nuk do të përsërisë vepër tjetër penale të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Vendimin për konfiskimin e armës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 60 lidhur me nenin 328 par.5 të KPK.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 450 par.2 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 365 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
P.nr.19/09, me datë 14.08.18

Sekretarja juridike,
Albulena Ademi

Kryetarja e trupit gjykues-gjyqtarja,
Suzana Çerkini

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.